



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

REKTORATI

Nr. 3634 prot.

Shkodër, më 28.10.2019

URDHËR

Nr. 334 datë 28.10 2019

**"PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT AD-HOC TË PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË APLIKIMEVE PËR BURSË PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020"**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr.10296, dt.08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Ligjit nr.99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", VKM-së nr.903, dt.21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" (i ndryshuar)

**Urdhëroj:**

1. Fillimin e procesit të pranimit të aplikimeve për trajtimin me bursë për vitin akademik 2019-2020 në programet e studimit të ciklit të parë.
2. Afati i aplikimit është nga data 28.10.2019-18.11.2019
3. Krijimin e komisionit AD-HOC të pranimit dhe shqyrtimit të aplikimeve për trajtim me bursë për vitin akademik 2019-2020 në programet e studimit të ciklit të parë i përbërë nga:

Lindita Kastrati	kryetare
Enejda Dani	anëtare
Erard Çurçija	anëtar
Mimoza Kastrati	anëtare
Lidia Laca	anëtare
Suzana Lika	anëtare
Elton Shpuza	anëtar
4. Menjëherë me daljen e urdhrit specialisti i bursave znj.Saida Bizaku dorëzon tek kryetari i këtij komisioni me shkresë zyrtare listat e studentëve që kanë përfituar bursë vitin akademik 2018-2019.
5. Kryetari i komisionit koordinon punën dhe ngarkon me detyra specifike anëtarët e komisionit.
6. Komisioni mbledh aplikimet e studentëve të rregullt sipas afatit të sipërcituar në pikën 2 të këtij urdhri, harton relacionin shoqërues brenda 5 ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit për aplikim.

